



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.92

18 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.523, datë 13.5.2009	Për miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës	4103
Vendim i KM nr.524, datë 13.5.2009	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve	4107
Vendim i KM nr.525, datë 13.5.2009	Për miratimin e rregullores për nënshkrimin elektronik	4112
Vendim i KM nr.532, datë 27.4.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	4116
Udhëzim i KQZ nr.18, datë 3.6.2009	Për mënyrën e organizimit të punës në VNV, rregullat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja dhe GNV-të, radhën e veprimit dhe ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit të votave	4119
Udhëzim i KQZ nr.19, datë 9.6.2009	Për procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve, për zgjedhjet për kuvend, të datës 28 qershor 2009	4126
Vendim i ERE nr.38, datë 18.5.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin e Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit)	4128

Vendim i ERE nr.39, datë 18.5.2009	Për fillimin e procedurave për disa ndryshime dhe shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike	4129
Vendim i ERE nr.40, datë 18.5.2009	Për miratimin e rregullores për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike	4129
Vendim i KKRT nr.853, datë 15.5.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TNSH”	4130
Vendim i KKRT nr.857, datë 15.5.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Cable Tel”	4130
Kërkesë e MPPTT nr.1680/1, datë 19.5.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano Durrës”	4131
Kërkesë e MPPTT nr.1732/1, datë 21.5.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i ndërtimit të segmentit rrugor “Rruga Hyrëse-Fier”	4133
Kërkesë e MPPTT nr.1381/2, datë 22.5.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”	4135
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Zamira Idajet Sinjari	4138

VENDIM
Nr.523, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONTRIBUTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË
KËSHILLIT TË EUROPËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE KONTRIBUTI
NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Organizatë Ndërkombëtare, Paris (këtu dhe më tej quhet CEB), nga njëra anë,
dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi i grantit), i përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu dhe më tej quhet MF), si huamarrës ndaj CEB-it për financimin e pjesës së projektit F/P 1385 Add 4 rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë, të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it, në 14 nëntor 2007;

meqenëse, nëpërmjet një marrëveshjeje të nënshkruar më 19 prill 2004 dhe marrëveshjet e saj shtesë, CEB-i dhe Mbretëria e Norvegjisë kanë rënë dakord të krijojnë një llogari mirëbesimi në CEB për qëllimin e financimit të aktiviteteve të projekteve të ndryshme, që mbështesin reformat sociale dhe ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me objektivin përfundimtar të ndihmesës së tyre për përgatitjen e një anëtarësimi të mundshëm në BE;

meqenëse, CEB-i, nëpërmjet llogarisë së mirëbesimit me Norvegjinë, dëshiron të japë një kontribut granti Përfituesit të grantit për të dhënë asistencë teknike për Ministrinë e Shëndetësisë (këtu dhe më tej quhet MSH) për zbatimin e projektit F/P 1385 Add 4 rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë (këtu e më tej quajtur “Projekti”), siç është përmbledhur në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje;

meqenëse, pritet që CEB-i dhe Përfituesi i grantit të nënshkruajnë një marrëveshje kuadër huaje (këtu e më tej quhet MKH) për projektin F/P 1385 Add rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës - faza e tretë në shumën 6 000 000 euro dhe MKH është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, më 9 tetor 2008;

dhe meqenëse, qëllimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet CEB-it dhe Përfituesit të grantit është të caktojë afatet dhe kushtet në lidhje me transferimin dhe menaxhimin e këtij granti për projektin; atëherë CEB-i dhe Përfituesi i grantit bien dakord si vijon:

Neni 1
Granti

1.1 CEB-i, në mënyrën e përmendur në paragrafin 1.2 të këtij neni, do të vërë në dispozicion të MF-së një shumë prej 150 000 eurosh që përputhet me grantin, këtu dhe më tej të quajtur “Granti”, që do të disbursohet në një kësht të vetëm sipas përshkrimit në shtojcën A.

1.2 CEB-i do të depozitojë shumën e grantit në një llogari të veçantë të projektit të hapur në Bankën Qendrore të Shqipërisë nga MF-ja.

MF-ja do t'i kalojë të gjitha shumat nga kontributi i CEB-it nëpërmjet një llogarie të veçantë të hapur në një bankë tregtare nga MF-ja dhe të caktuar vetëm për këtë projekt. MSH-ja nëpërmjet PIU-t (shih 4.2) do të autorizohet për të operuar llogarinë e veçantë. Të gjitha transaksionet do të jenë të autorizuar, regjistruara dhe raportuara nga MSH-ja nëpërmjet PIU-t.

1.3 Granti do të paguhet në euro. Të gjitha llogaritë dhe pasqyrat financiare do të shprehen në euro.

Neni 2

Kushtet për përdorimin e grantit

2.1 Granti, i vënë në dispozicion nga CEB-i, do të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është planifikuar (shtojca A).

2.2 Çdo ndryshim i rëndësishëm në projekt do t'i nënshtrohet pëlqimit me shkrim nga CEB-i para se këto ndryshime të përfshihen në projekt. Nëse ndodh ndonjë ndryshim që, sipas mendimit të CEB-it, mund të pengojë impaktin e projektit, CEB-i, rezervon të drejtën të pezullojë, anulojë ose kërkojë shlyerjen e menjëhershme të grantit.

2.3 MF-ja nëpërmjet MSH-së do të tregojë të gjithë kujdesin dhe vëmendjen dhe do të ushtrojë të gjitha mjetet, normalisht të përdorshme, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxhuese që do të jenë të nevojshme për administrimin e përshtatshëm të grantit.

2.4 Çdo shumë që mbetet e pashpenzuar pas përfundimit të projektit sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të ardhurat nga interesi që i përkasin grantit, i rikthehen CEB-it në euro, përveç kur është rënë dakord ndryshe.

2.5 MF-ja nëpërmjet MSH-së do të sigurojë praninë e Mbretërisë së Norvegjisë dhe CEB-it duke njoftuar përfituesit e projektit në lidhje me pjesëmarrjen e CEB-it, nëpërmjet llogarisë së mirëbesimit të Norvegjisë në financimin e projektit.

Neni 3

Përgjegjësia për projektin

3.1 Përfituesi i grantit cakton MSH-në për zbatimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin. Sidoqoftë, përgjegjësia për përputhshmërinë me të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje mbetet e Përfituesit të grantit.

3.2 MSh-ja do të përdorë të njëjtën njësi zbatimi projektesh (PIU), të krijuar brenda strukturës së saj për projektin F/P 1384 Add 4-rehabilitimi i spitalit të Shkodrës – faza e tretë. PIU është ekipi i MSH-së, i ngarkuar për zbatimin e përditshëm, menaxhimin fizik dhe financiar dhe ndjekjen e projektit.

3.3 MSH-ja, nëpërmjet PIU-t, do të ketë përgjegjësinë për fondet e marra prej CEB-it, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit, dhe do të informojë CEB-in dhe MF-në rreth ecurisë së projektit, duke i dërguar CEB-it raporte siç parashikohet më tej në nenin 6, më poshtë.

Neni 4

Zbatimi i projektit

4.1 Granti do të mbulojë deri në 100% të kostove të përgjithshme të projektit, sipas përshkrimit në shtojcën A. CEB-i nuk merr përsipër të mbulojë asnjë shpenzim përtej shumës së grantit prej 150 000 eurosh.

4.2 MF-ja do të sigurojë se MSH/PIU do të përdorin grantin e CEB-it në përputhje me procedurat e projektit F/P 1385 Add 4, përfshirë tenderimin, prokurimin, monitorimin e punimeve.

4.3 Nëse pritjet të ndodhin apo kanë ndodhur rritje të paparashikuara në shpenzime ose në detyrime (qoftë për shkak të faktorëve të inflacionit, luhatjes në kurset e këmbimit ose rasteve të paparashikuara), MF-ja do të sigurojë që MSH/PIU do ta njoftojë rregullisht CEB-in në kohë për rritjet.

Neni 5
Kontabiliteti

5.1 MSH-ja nëpërmjet PIU-t do të mbajë regjistra të llogarive në lidhje me projektin, të cilat janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, që tregojnë, në çdo moment, gjendjen e ecurisë së projektit, dhe që do të regjistrojnë të gjitha veprimet e bëra me ndihmën e këtij granti. Granti i CEB-it do t'u nënshtrohet procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të parashikuara në rregulloret financiare, rregullat dhe direktivat e zbatueshme për MSH-në dhe për projektin F/P 1385 Add 4.

Neni 6
Monitorimi dhe raportet

6.1 MF-ja do të sigurojë që raportimi i MSH/PIU mbi shpenzimet e shkaktuara do të shprehet në euro ose, nëse pagesat duhet të bëhen në një monedhë tjetër, duke konvertuar në euro, shumat përkatëse të paguara, sipas kursit të këmbimit ndërbankar në ditën e pagesës së kontraktuesit në monedhën e ndryshme nga euro.

6.2 MF-ja do të sigurojë që MSH/PIU do t'i japë CEB-it të gjitha raportet e përgatitura në përputhje me procedurat ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit.

6.3 MF-ja do të sigurojë që MSH/PIU do të dërgojë raporte vjetore pas datës së nënshkrimit dhe një raport përfundimi CEB-it dhe MF-së pas përfundimit të aktiviteteve që mbështeten nga ky grant. Raporti i përfundimit do të përfshijë një vlerësim të aktiviteteve dhe një raport financiar. Ky raport përfundimi duhet të jetë i pranueshëm për CEB-in dhe MF-në.

6.4 MF-ja do të sigurojë që MSH/PIU do t'u japë përfaqësuesve të CEB-it mundësinë e përdorimit të dokumentacionit të projektit, duke përfshirë regjistrat e llogarive në lidhje me projektin.

Neni 7
Njoftimi

7.1 Çdo njoftim që duhet t'i bëhet një pale në lidhje me këtë Marrëveshje, i bëhet ose i dërgohet efektivisht me letër ose faks palëve në adresat e mëposhtme. Adresat e secilës palë mund të ndryshohen me njoftim në mënyrën e përcaktuar në këtë dispozitë.

7.2 Çdo njoftim për CEB-in do të adresohet te:

Drejtori i Përgjithshëm për Huatë
Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
55, avenue Kléber
75784 Paris CEDEX 16 – Francë
Faks: 33 1 47 55 37 52

Çdo njoftim për MF-në adresohet te:

Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e kombit", nr.1, Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: +355 22 84 94

Neni 8
Amendimet

8.1 Kjo Marrëveshje mund të modifikohet nëpërmjet një amendimi formal nga CEB-i dhe MF-ja, secili prej të cilave shqyrton plotësisht çdo propozim për ndryshim.

Neni 9
Mosmarrëveshjet

9.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në marrëveshje do të jenë subjekt i arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huave të CEB-it.

Neni 10
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

10.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve dhe pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Marrëveshja pushon së qeni në fuqi tridhjetë ditë pasi një nga palët mund të ketë bërë njoftim me shkrim për palët e tjera, në lidhje me vendimin e saj për të përfunduar marrëveshjen për arsye të motivuara rregullisht.

10.3 Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi në bazë të rendit të mëposhtëm të ngjarjeve:

- disbursimi nga CEB-i për Përfituesin e grantit, të grantit të plotë;
- përdorim i plotë i grantit ose rimbursimi i mundshëm ndaj CEB-it nga Përfituesi i grantit, të çdo shume që mbetet e pashpenzuar pas përfundimit të projektit;
- paraqitja e një raporti përfundimi nga MSH/PIU te CEB-i, si dhe pranimi prej CEB-it dhe prej MF-së i raportit të sipërpërmendur të përfundimit sipas përcaktimit të nenit 6.3 më sipër.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në tri kopje.

Nënshkruar në _____
Më _____
Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Europës

Emri: _____
Titulli: _____

Nënshkruar në _____
Më _____
Për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë

Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA A
PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Projekt	Asistencë teknike për zbatimin e projektit F/P 1385 Add 4 rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë
Vendi	Shqipëri
Agjencia zbatuese	MSH-ja nëpërmjet PIU-t
Përfituesit	Personeli i spitalit të Shkodrës do të përfitojë nga trajnimi që do të jepet nga konsulentët teknikë.
Shuma e grantit	150 000 euro
Periudha e zbatimit	Burimet e grantit do të shpenzohen në përputhje me zbatimin e projektit F/P 1385 Add 4.
Shpenzimet e planifikuara	Granti do të mbulojë komponentin e trajnimit (kryesisht, shërbime të konsulencës për menaxhimin e spitalit), në kuadrin e projektit F/P 1385 Add 4 – rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë.
Efektet sociale	Spitali rajonal i Shkodrës është qendra më e rëndësishme shëndetësore për pacientët e shtruar dhe ata të jashtëm në veriun e Republikës së Shqipërisë. Menjëherë pas përfundimit të fazës së tretë, spitali do të zbatojë kritere të reja të shërbimeve shëndetësore dhe do të përfshijë një bashkërendim të mirë ndërmjet shërbimeve të specializuara, një plan konstruksioni të përshtatshëm për pacientët dhe personelin, një fleksibilitet të gjerë

	për ndryshime të mundshme, standarde të përshtatshme të kujdesit, të gjitha këto në interesin e lartë të pacientëve të shtruar dhe ata të jashtëm të qarkut të Shkodrës.
Procedurat e disbursimit	Në një kësht të vetëm prej 150 000 eurosh. Disbursimi do të bëhet pas nënshkrimit të marrëveshjes së kontributit.

VENDIM
Nr.524, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS, MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, në emër të shteteve të tyre përkatëse, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”,

të nisura nga dëshira për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore që tashmë ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

duke konfirmuar se respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe humanizmit përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes;

me synimin për të lehtësuar kontaktet e shtetasve me njëri-tjetrin si një instrument i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve dhe mbështetjes për zhvillim në të gjitha fushat e veprimtarisë;

të bindura se liria e lëvizjes njerëzore përbën një zhvillim themelor për forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve të secilit vend për integrimin në Bashkimin Europian, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

1. Shtetasit e secilës palë do të hyjnë, do të largohen, do të qëndrojnë dhe do të kalojnë tranzit nga territori i Palës tjetër Kontraktuese në bazë të një dokumenti të vlefshëm udhëtimi, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

2. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave kombëtare do të përjashtohen nga detyrimi për t’u pajisur me vizë hyrëse në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një qëndrim jo më të gjatë se (90) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes së parë.

3. Shtetasit e secilit vend do të hyjnë, do të kalojnë tranzit, do të qëndrojnë përkohësisht dhe do të largohen nga territori i Palës tjetër Kontraktuese në të gjitha pikat e kalimit kufitar, të hapura për qarkullimin ndërkombëtar, duke pasur një dokument të vlefshëm udhëtimi si ato që listohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

4.Shtetasit e secilit vend do të hyjnë, do të kalojnë tranzit, do të qëndrojnë përkohësisht dhe do të largohen nga territori i secilës Palë Kontraktuese, pa taksa dhe tarifa për periudhën e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 2

Shtetasit e Palëve Kontraktuese, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë që nuk kalon 90 (nëntëdhjetë) ditë, do t'u referohen dhe respektojnë dispozitat e legjislacionit të brendshëm të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Në rast se për shkaqe të forcës madhore, një shtetas nuk ka mundësi për t'u larguar nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, brenda afatit të vlefshmërisë së qëndrimit, Pala Kontraktuese pritëse do të bëjë pa pagesë zgjatjen e periudhës së qëndrimit.

Neni 4

Shtetasit e Palëve Kontraktuese që qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë të parashikuar në nenin 1 paragrafi 2 nuk do të kenë të drejtën e punësimit.

Neni 5

Shtetasit e Palëve Kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese do të veprojnë në përputhje me legjislacionin e kësaj të fundit.

Neni 6

Secila Palë Kontraktuese mund t'u refuzojë hyrjen ose të përfundojë qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese, të cilët ajo, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i gjykon si të papranueshëm ose të padëshirueshëm.

Neni 7

1.Kur shtetasit e Palës Kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese humbasin pasaportat e tyre ose ndonjë dokument tjetër zëvendësues udhëtimi sipas listës në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, do të njoftojnë menjëherë për këto raste autoritetet përkatëse vendore, të cilat nga ana e tyre do t'u lëshojnë një dokument njoftues ndihmës.

2.Misioni diplomatik i secilës Palë Kontraktuese do t'u lëshojë shtetasve të tij, sipas paragrafit 1 të këtij neni, një dokument të ri të përshtatshëm udhëtimi, pa vonesa dhe jo më vonë se 7 ditë.

3.Në rast se në territorin e secilës Palë Kontraktuese nuk ka mision diplomatik të Palës tjetër Kontraktuese, shtetasve të Palës Kontraktuese, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do t'u lëshohet një certifikatë njoftimi për të huajt nga shteti pritës për qëllim të kthimit.

4.Të dyja, dokumenti i udhëtimit dhe njoftimi do të paraqiten në pikat e kalimit kufitar.

Neni 8

Palët Kontraktuese do të këmbëjnë specimenet e pasaportave të tyre të vlefshme, nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kur njëra Palë Kontraktuese lëshon një model të ri të dokumentit të udhëtimit apo i modifikon dokumentet tashmë të këmbëra, për këto modifikime duhet të njoftohet Pala tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së hyrjes në qarkullim të dokumentit të ri ose të modifikuar. Ky njoftim duhet të përfshijë modelin e dokumenteve të reja ose të modifikuara dhe informacione mbi zbatueshmërinë e tyre.

Neni 9

Palët Kontraktuese do të krijojnë një Komitet të Përbashkët, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, i cili do të ketë për detyrë:

- monitorimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që rrjedh nga interpretimi apo zbatimi i dispozitave të Marrëveshjes; dhe
 - propozimin e modifikimeve dhe ndryshimeve të kësaj Marrëveshjeje.
- Komiteti do të mbledhet sa herë që të jetë e nevojshme, me kërkesën e njëres prej Palëve Kontraktuese dhe të paktën një herë në vit.
- Komiteti do të vendosë rregullat e tij të procedurës në takimin e tij të parë.

Neni 10

1. Secila nga Palët Kontraktuese, mund ta pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, veprimin e kësaj Marrëveshjeje, në rastin e një fatkeqësie natyrore, epidemie apo për shkak të konsideratave të sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

2. Pala tjetër Kontraktuese do të njoftojë menjëherë për pezullimin e efekteve të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Pezullimi i veprimit të kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi ditën e dërgimit dhe konfirmimit të njoftimit. Në rast të kundërt, ajo do të hyjë në fuqi 3 (tre) ditë nga dita e dërgimit të njoftimit.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të papërcaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë ndërmjet Palëve Kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Secila prej Palëve Kontraktuese mund ta përfundojë tërësisht ose pjesërisht këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja ose pjesë të saj do të pushojnë së vepruari pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Sarajevë, më 24 mars 2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, boshnjake, kroate, serbe dhe anglisht duke pasur secili nga tekstet fuqi të barabartë. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Bosnjë-
Hercegovinës

ANEKS

I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS

Dokumentet e vlefshme që konfirmojnë identitetin, të nevojshme për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve të Bosnjës dhe Hercegovinës:

1. Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë që udhëtojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë, dokumente të vlefshme udhëtimi janë:

- pasaporta për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, që konfirmon identitetin e shtetasit të Republikës së Shqipërisë jashtë;
- pasaporta e detarit (karta e identitetit të detarit), së bashku me dokumentet e anijes ose një ekstrakt të dokumenteve të tyre;
- një certifikatë udhëtimi për qëllimin e kthimit në Republikën e Shqipërisë (vetëm për qëllimin e kthimit në Republikën e Shqipërisë);

- një deklaratë të përgjithshme (plani i fluturimit) me hyrjet e anëtarëve të ekuipazhit të avionëve të transportit civil të Palëve Kontraktuese.

2. Për shtetasit e Bosnjës dhe Hercegovinës, që udhëtojnë në Republikën e Shqipërisë, dokumente të vlefshme udhëtimi janë:

- pasaporta për shtetasit e Bosnjës dhe Hercegovinës, që konfirmon identitetin e shtetasit të Bosnjës dhe Hercegovinës jashtë;

- pasaporta e detarit (karta e identitetit të detarit), së bashku me dokumentet e anijes ose një ekstrakt të tyre;

- një certifikatë udhëtimi për qëllimin e kthimit në Bosnjë dhe Hercegovinë (vetëm për qëllimin e kthimit në Bosnjë dhe Hercegovinë);

- një deklaratë të përgjithshme (plani i fluturimit) me hyrjet e anëtarëve të ekuipazhit të avionëve të transportit civil të Palëve Kontraktuese.



DOKUMENT UDHËTIMI

I vlefshëm për një udhëtim nga:

Vendi i nisjes:

Destinacioni:

Mbiemri:

Emri:

Ditëlindja:

Gjatësia:

Shenja Dalluese:

Shtetësia:

Adresa në vendin e lindjes (nëse dihet):

Autoriteti lëshues:

Lëshuar në:

Lëshuar më:

Firma:

AUTORITETI

Shënime: _____

VENDIM
Nr.525, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 19, 28, 52 e 54 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për nënshkrimin elektronik, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK

I. Dispozita të përgjithshme

1. Objekti i rregullore

Në zbatim të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, kjo rregullore përcakton:

- a) Mënyrën e regjistrimit pranë autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik (autoriteti);
- b) Kërkesat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore që duhet t'i zotërojnë dhe zbatojnë ofruesit e shërbimit të certifikimit, në zbatim të neneve 19 dhe 28 të ligjit;
- c) Procedurat për shfuqizimin dhe çregjistrimin e certifikatave të kualifikuara dhe mënyrat e informimit, në zbatim të nenit 14 të ligjit;
- d) Organizmat e testimit dhe të konfirmimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit;
- e) Njohjen dhe pranimin e nënshkrimeve elektronike dhe produkteve të huaja, në zbatim të nenit 54 të ligjit.

II. Regjistrimi

2. Regjistrimi në autoritet

a) Ofruesi i shërbimit të certifikimit regjistrohet pranë autoritetit jo më vonë se dita e fillimit të aktivitetit, dhe njëkohësisht paraqet dëshmitë e nevojshme që tregojnë se subjekti plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore.

b) Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacione shtesë apo përgatisë udhëzime teknike të hollësishme në lidhje me kërkesat teknike, profesionale e ligjore që përcaktohen në ligj dhe në këtë rregullore dhe, që lidhen me ushtrimin e aktivitetit nga ofruesit e shërbimit të certifikimit apo organizmit të testimit e konfirmimit.

c) Regjistrimi në autoritet duhet minimalisht të shoqërohet me këto të dhëna dhe dokumente:

- i) Emrin dhe adresën e ofruesit të shërbimit të certifikimit;
- ii) Dëshmitë përkatëse të fillimit të aktivitetit;
- iii) Dokumentet që provojnë se plotëson kushtet ligjore, profesionale, teknike dhe financiare të përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore;

iv) Çdo dokument tjetër që lidhet me aktivitetin që do të kryhet.

d) Formulimi i të gjithë dokumentacionit që paraqitet pranë autoritetit duhet të jetë konform ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

III. Kushtet ligjore, profesionale, teknike dhe financiare

3. Besueshmëria ligjore

Ofruesi i shërbimit të certifikimit që fillon aktivitetin duhet të dëshmojë se plotëson kërkesat e mëposhtme:

- a) Të jetë person juridik ose fizik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:
 - i) Vjedhje;
 - ii) Mashtrim;
 - iii) Korrupsion;
 - iv) Pastrim parash;
 - v) Pjesëmarrje në organizata kriminale;
 - vi) Vepra që lidhen me veprimtaritë profesionale;
- c) Të mos jetë në proces falimentimi dhe kapitalet e tij të jenë në duart e përmbaruesit ose në proces konfiskimi, si dhe kur veprimtaria e tij e biznesit është e pezulluar apo është në ndjekje ligjore për ndonjë nga çështjet e përmendura në pikën 3(b) të kësaj rregulloreje.

4. Besueshmëria profesionale

Ofruesi i shërbimit të certifikimit demonstroi se zotëron aftësitë organizativo-profesionale dhe personelin e përshtatshëm sipas kërkesave që përcaktohen në vijim:

- a) Për zotërimin e aftësive organizativo-profesionale, ofruesi i shërbimit të certifikimit duhet:
 - i) të organizohet në atë mënyrë që krijimi dhe lëshimi i certifikatave apo nënshkrimeve elektronike të avancuara të jetë i ndarë nga çdo aktivitet tjetër i tij;
 - ii) të parashikojë dhe dokumentojë me shkrim të gjitha masat e detajuara në lidhje me sigurinë, në përmblotje të kërkesave ligjore dhe standardeve të sigurisë;
 - iii) të hartojë procedura për të vlerësuar dhe për të siguruar besueshmërinë e personelit;
 - iv) të hartojë procedura për të vlerësuar dhe për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit në rastet e emergjencave që vijnë nga fatkeqësitë natyrore, gabimi njerëzor, ndërhyrjet e qëllimshme;
 - v) të parashikojë që krijimi ruajtja, përdorimi dhe restaurimi i kodeve private të kryhet me pjesëmarrjen e njëkohshme e të paktën dy punonjësve të autorizuar;
 - vi) të përcaktojë qartë zonën e mbrojtur fizike, ku ruhen të gjitha kodet kontrolluese dhe ku menaxhohen certifikatat e lëshuara, si dhe të autorizojë punonjës të caktuar, që gëzojnë të drejtën e hyrjes në zonën e mbrojtur.

b) Për zotërimin e personelit të besueshëm ofruesi i shërbimit të certifikimit duhet:

- i) të punësojë personel të specializuar në fusha të tilla si: shkencë kompjuterike, informatikë, kriptografi;
- ii) të punësojë personel, që i përmblot kërkesat e pikës 3(b) të kësaj rregulloreje;
- iii) të përgatisë përshkrime të qarta pune që nga koha e fillimit të aktivitetit për disa funksione minimalisht të nevojshme dhe të ndara, siç janë administratori i sistemit, administratori i sigurisë, operatori i përditshëm i sistemit dhe mbikëqyrja e administrimit të dosjeve dhe arkivave, që përmblot në të dhëna për operacionet që kryhen nga sistemi.

5. Besueshmëria teknike

a) Ofruesi i shërbimit të certifikimit për administrimin e sigurisë aplikon metoda, që janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare;

b) Besueshmëria e sistemit të përdorur dhe siguria teknike dhe kriptografike e proceseve që kryen, konfirmohen pasi të kenë kaluar testimet e nevojshme, nga organizmat e përcaktuar në nenin 52 të ligjit dhe në këtë rregullore;

c) Metodat e vlerësimit të sigurisë së sistemit të përdorur duhet të bazohen në metodat e parashikuara nga standardet ISO 15408 (Organizata Ndërkombëtare për Standardizimet) ose më të avancuara, apo metoda ekuivalente, që janë në gjendje të bëjnë vlerësimin e sigurisë;

d) Çdo pajisje apo sistem i përdorur për certifikim nga ofruesi i shërbimit për krijimin, nënshkrimin, ruajtjen dhe administrimin e certifikatave duhet të disenjohen vetëm për këtë qëllim;

e) Çdo sistem dhe pajisje teknike e përdorur nga ofruesi i shërbimit të certifikimit për ofrimin e shërbimit për krijimin, ruajtjen dhe administrimin e certifikatave projektohet për t'u përdorur vetëm për këtë qëllim, dhe për asnjë tjetër;

f) Testimet për të verifikuar besueshmërinë e sistemeve dhe pajisjeve të përdorura nga ofruesi i shërbimit të certifikimit dhe të kërkuara sipas pikës 5 (b) të kësaj rregulloreje, bëhen normalisht çdo 2(dy) vjet dhe sa herë që ka ndryshime në sistem, të cilat kërkojnë verifikimin e ruajtjes së besueshmërisë pas ndryshimeve;

g) Krijimi, ruajtja dhe përdorimi i çelësve privatë të çdo ofruesi të shërbimit të certifikimit duhet të realizohen brenda sistemit, me një profil mbrojtjeje në përputhje me kërkesat e sigurisë së nivelit

EAL 3 (Vlerësimi i nivelit të garancisë) të vlerësimit të sigurisë ose më i avancuar, në përputhje me standardin ISO 15408 ose specifikime të tjera me nivele ekuivalente të sigurisë;

h) Ofruesi i shërbimit të certifikimit përdor pajisje dhe teknologji që mundëson realizimin e funksioneve bazë si më poshtë:

i) testimin për të provuar origjinën e informacionit të marrë dhe të shkëmbyer;

ii) testimin e integritetit të mesazheve të shkëmbyera;

iii) nënshkrimin e mesazheve të shkëmbyera;

iv) arkivimin e informacionit mbi punën e kryer dhe nënshkrimeve elektronike;

v) sigurimin e integritetit të të dhënave të ruajtura dhe të shkëmbyera, përfshirë çelësat kriptografikë të përdorur;

vi) ruajtjen e çelësve privatë të përdorur nga ofruesi i shërbimit të certifikimit;

vii) administrimin e aksesit të burimit të informacionit që lidhet me të dhënat për krijimin e nënshkrimit të avancuar, listën e certifikatave që janë mbyllur dhe korrespondenca zyrtare e ruajtur në sistem;

viii) krijimin dhe arkivimin e rekordeve të auditit të brendshëm.

i) Çdo ofrues i shërbimit të certifikimit duhet të kryejë nëpërmjet pajisjes dhe teknologjisë së instaluar prej tij këto funksione:

i) të testojë nënshkrimet elektronike të avancuara në përputhje me kërkesat teknike për nënshkrimet elektronike të parashikuara nga CEN/ISSS (Komiteti Europian për Standardizimet);

ii) të jetë në gjendje të përdorë protokollin OCSP (Protokolli i Statusit të Certifikatës On-line);

iii) ofruesi i shërbimit të certifikimit për standardet e pajisjeve dhe teknologjisë, që nuk janë përcaktuar në këtë rregullore, përdor standardet ndërkombëtare të organizmave të specializuara si Instituti Europian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI), Komiteti Europian për Standardizimet (CEN/ISSS).

6. Besueshmëria financiare

a) Ofruesi i shërbimit të certifikimit demonstroi se disponon garancitë e nevojshme financiare, që bëjnë të mundur mbulimin e përgjegjësisë ligjore, që rrjedhin nga neni 41 i ligjit. Garancia minimale financiare duhet të jetë 100 milionë lekë;

b) Vlera e garancisë e përcaktuar në pikën 6(a) të kësaj rregulloreje mbulohet me një depozitë ose garanci bankare, apo policë sigurimi pa kusht, të lëshuar nga një shoqëri e licencuar në fushën e sigurimeve dhe që mbulon edhe këtë kategori shërbimi. Garancitë financiare duhet të jenë të vlefshme përgjatë gjithë kohës së aktivitetit të ofruesit të shërbimit dhe duhet të mbulojnë të gjitha ngjarjet e siguruara;

c) Pavarësisht nga garancia financiare e parashikuar në pikën 6(a), ofruesi i shërbimit për çdo certifikatë të kualifikuar të lëshuar, duhet të sigurohet nga dëmet që mund t'i vijnë zotëruesit të nënshkrimit nga shkeljet e ligjit apo mosfunksionimi si duhet i produktit të tij, si më poshtë:

i) Deri në 5 milionë lekë për çdo dëm të shkaktuar, kur certifikata e kualifikuar është e kufizuar në disa veprime financiare apo kufizime të tjera të përcaktuara nga palët;

ii) Deri në 10 milionë lekë, kur certifikata e kualifikuar është e pakufizuar dhe universale.

Kërkesat e mësipërme nuk e ndalojnë ofruesin e shërbimit të certifikimit që në mënyrë vullnetare të ofrojë polica sigurimi me vlera më të larta se ato të parashikuara në këtë pikë.

7. Detyrimi për informim

Në zbatim të nenit 32 të ligjit, ofruesi i shërbimit të certifikimit është i detyruar t'i informojë aplikuesit për certifikatë të kualifikuar në lidhje me:

i) Mjetet e prodhimit e të ruajtjes së nënshkrimit dhe masat që merren në rast të humbjes ose dyshimit për përvetësim të certifikatës së kualifikuar;

ii) Mjetet e ruajtjes dhe sqarime për konfidencialitetin e të dhënave personale të përdorura;

iii) Masat e sigurisë që aplikon ofruesi i shërbimit të certifikimit për ruajtjen e nënshkrimit elektronik;

iv) Kufizimet e mundshme që do të ketë certifikata e kualifikuar;

v) Njoftimin se përdorimi i certifikatës së kualifikuar është vullnetar;

vi) Njoftimin mbi procedurën e revokimeve;

vii) Njoftimin mbi mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesave.

Informacioni i paraqitur sipas kësaj pike, duhet të jetë hartuar në mënyrë të kuptueshme për klientët dhe t'i bëhet i ditur çdo pale të interesuar.

IV. Organizmat e testimit dhe konfirmimit

8. Njohja si organizëm testimi e konfirmimi

a) Organizëm testimi dhe konfirmimi njihet çdo organ që plotëson kushtet e mëposhtme:

i) Zotëron të gjitha certifikatat apo njohuritë e nevojshme që lidhen me certifikimin e ofruesve të shërbimit të certifikimit, me pajisjet dhe proceset, që lidhen me shërbimin e certifikimit të avancuar, të njohura nga praktika më e mirë ndërkombëtare apo organizma të standardizimit në këtë fushë;

ii) Plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara nga pika 3 e kësaj rregulloreje;

iii) Nuk ka konflikt interesi dhe personeli i tij nuk është përfshirë në ndonjë aktivitet që mund të ndikojë në vlerësimin profesional dhe të pavarur të tyre;

iv) Zotëron pavarësi financiare në mbulimin e aktivitetit përkatës;

v) Siguron transparencë të plotë për aktivitetin që kryen dhe disponon raporte të hollësishme për çdo aktivitet të kryer;

vi) Disponon personel dhe mjete të nevojshme në lidhje me fushën apo aktivitetin specifik teknik që do të certifikojë;

vii) Garanton konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrës dhe gatishmërinë për t'ia vënë në dispozicion autoritetit kurdoherë që ndërpret aktivitetin në fjalë.

b) Autoriteti duhet të hartojë një listë të plotë të kërkesave specifike për çdo kusht të përcaktuar në pikën 8(a), si dhe të publikojë një listë të përditësuar të organizmave të testimit e konfirmimit;

c) Autoriteti mund të njohë organizmat e testimit e konfirmimit për të gjithë ose për një pjesë të proceseve apo përbërësve që lidhen me nënshkrimin elektronik;

d) Organizmi i testimit dhe konfirmimit duhet të paktën para fillimit të shërbimeve të testimit dhe konfirmimit të bëjë të njohur tarifat që do të aplikohen ndaj ofruesve të shërbimit të certifikimit;

e) Organizmi i testimit dhe konfirmimit certifikon me shkrim ose hedh poshtë plotësisht ose pjesërisht subjektin e kontrolluar. Konkluzionet i bëhen të ditura autoritetit në afatet e përcaktuara nga ky i fundit;

f) Konfliktet mes organizmave të testimit e konfirmimit dhe ofruesve të shërbimit të certifikimit zgjidhen me ndërhyrjen e autoritetit ose/dhe në rrugë gjyqësore;

g) Në rastet, kur pranë autoritetit nuk rezulton asnjë organizëm testimi dhe konfirmimi i regjistruar, aktiviteti i ofruesit të shërbimit të certifikimit quhet i mirëqenë dhe nuk ndërpritet, por afatet e raportimit dhe inspektimi nga autoriteti përgjysmohen.

9. Përgjashtimet

Bëjnë përjashtim nga vlerësimi produktet e huaja të shoqëruara me deklaratën e prodhuesit, që vërtetohet përmblotshëm e standardeve teknike ndërkombëtare të konfirmuara këto nga organizmat e testimit dhe konfirmimit në vendin e origjinës.

V. Shfuqizimi, revokimi dhe informimi i të tretëve

10. Shfuqizimi dhe revokimi i certifikatave

Shfuqizimi dhe revokimi i certifikatave bëhet në rastet e parashikuara në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik".

11. Veprimet që shoqërojnë revokimin/shfuqizimin

a) Një certifikatë e revokuar/shfuqizuar nuk mund të hyjë më në përdorim në asnjë rrethanë.

b) Ofruesi i shërbimit të certifikimit mundëson pezullimin e menjëhershëm të certifikatës, deri në daljen dhe verifikimin ose jo të shkaqeve për revokimin apo shfuqizimin e certifikatës.

c) Ofruesi i shërbimit të certifikimit njofton menjëherë zotëruesin e certifikatës elektronike rreth pezullimit/revokimit të certifikatës përkatëse dhe evidenton kryerjen e njoftimit në kohë.

d) Ofruesi i shërbimit të certifikimit siguron shërbim të vazhdueshëm për revokimin e certifikatës 24 orë në ditë, çdo ditë të javës, duke përfshirë edhe ditët e pushimeve, në mënyrë që mbajtësi i certifikatave të kualifikuara ose/dhe personat e autorizuar ligjërisht prej tyre, mund të dorëzojnë një kërkesë revokimi apo autoriteti lëshon një urdhër shfuqizimi. Në çdo rast, para revokimit, ofruesi i shërbimit të certifikimit verifikon nëse kërkesa është paraqitur nga një person që ka të drejtë ligjore për këtë gjë.

e) Kërkesa për revokim të certifikatës së kualifikuar përpunohet menjëherë. Ofruesi i shërbimit siguron mjete të përshtatshme komunikimi elektronik dhe informon zotëruesit e certifikatave për këtë, përfshirë edhe numrat e telefonit, faksit apo çdo mjet tjetër.

f) Ofruesi i shërbimit të certifikimit siguron shërbimin për dhënien e informacionit rreth statusit të certifikatave (të vlefshme/të revokuara/shfuqizuara), gjatë gjithë kohës 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, duke përfshirë edhe ditët e pushimit. Ky informacion duhet të pasqyrojë:

- i) Statusin e çdo certifikate;
- ii) Të paktën datën, kohën dhe kodin e identifikimit të certifikatave të evokuara/shfuqizuara;
- iii) Të jetë i hapur dhe pa pagesë për përfituesit e certifikatave ose dhe palët e treta.

VI. Nënshkrimet dhe produktet e huaja

12. Njohja e certifikatave të huaja

Nënshkrimet elektronike dhe produktet e huaja për nënshkrimet elektronike njihen dhe zbatohen në përputhje me aktmarrëveshjet e lidhura nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaja për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave, kur gëzojnë minimalisht besueshmërinë teknike dhe sigurinë që parashikon ligji nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik” dhe kjo rregullore.

13. Procedurat për njësimin e certifikatave dhe produkteve të huaja

a) Produktet dhe certifikatat e kualifikuara, të lëshuara nga një ofrues i shërbimit të certifikimit që vepron në një shtet të huaj, me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje, njihen vetëm pasi ofruesi i shërbimit të certifikimit lokal do të dorëzojë në autoritet të gjithë dokumentacionin që kërkohet për njohjen e certifikatës së kualifikuar sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

b) Dokumentacioni që i përket ofruesit të shërbimit të certifikimit të huaj duhet të jetë i konfirmuar nga autoriteti i vendit të origjinës se ai plotëson të gjitha kërkesat e nivelit të sigurisë dhe vlerësimit siç e përcakton ligji dhe kjo rregullore. Në çdo rast, ofruesi i shërbimit të certifikimit përgjigjet për sigurinë e certifikimeve të huaja që ai kërkon të përdorë në vendin tonë, si dhe për pasojat që mund të vijnë nga keqkuptimi i tyre.

c) Autoriteti publikon në regjistrin e përditësuar të certifikatave, kodet publike për verifikimin e certifikatave, të lëshuara nga ofruesit e shërbimit të huaj të njohura në Republikën e Shqipërisë.

VII. Dispozita kalimtare

14. Të gjitha ato subjekte që kanë filluar aktivitetin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda 30 ditëve nga miratimi i saj duhet të fillojnë procedurat e regjistrimit të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore.

VENDIM

Nr.532, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit 10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

a) Lidhja nr.1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë në degë inxhinieri elektronike apo informatikë, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, të parashikuara për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

PAGA BAZE SIPAS GRADES DHE VITEVE TE SHERBIMIT PER USHTARAKET AKTIVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA

		Vitet e sherbimit													
OFICERE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj.Lejtnant (Admiral)												Mbi 20			151500
Gj.Major (Nenadmiral)														142390	145000
Gj.Brigade (Kunderadmiral)													112000	114000	114000
Kolonel (Kapiten i rangut I-re)											88500	90000	92000	93600	96000
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-te)											67000	68200	69400	70600	71800
Major (Kapiten i rangut III-te)							52500	53500	54400	55300	57000	58500	59300		
Kapiten (Kapiten lejtant)			43500	44500	47000	48200	48800	49400	50000	50600	51200				
Toger (Lejtant)															
Nentoger (Nenlejtant)	39700	40450	41200	41950	42700	43450									
Vitet e sherbimit															
NENOFICERE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapier											48000	49000	50500	51500	52500
Kapier								40800	42200	42900	43500	45000	47000		
Rreshier								35800	37300	39600	40800	42200	42900		
Tetar								33600	34500	35000	35800	36500	37300	38100	38900
Nentetar	29000	29600	30800	32000	33600	34800									
Vitet e sherbimit															
USHTARE PROFESIONISTE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/ detar profesionist II	28900	30100	31300	32500	33600										
Ushtar/ detar profesionist I	26500	27700													
USHTARE TE SHERBIMIT TE DETYRUESHEM E STUDENTE USHTARAKE															
Vitet e sherbimit															
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/ Detar II	2000														
Ushtar rekrut I/ Detar I	1500														
Studente ushtarak	1500														

UDHËZIM
Nr.18, datë 3.6.2009

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË PUNËS NË VNV, RREGULLAT QË DUHEN NDJEKUR
NGA KZAZ-JA DHE GNV-TË, RADHËN E VEPRIMIT DHE NDARJEN E DETYRAVE MIDIS
ANËTARËVE TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 95, pika 3 dhe 5, nenit 115, nenit 116, nenit 117, nenit 118, nenit 119 dhe nenit 121 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit të punës, radhën e veprimeve në VNV, ndarjen e detyrave dhe funksionimin e GNV-së.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. KZAZ-ja organizon punën dhe garanton funksionimin korrekt të procesit të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore dhe të procesit të numërimit të votave.
2. Grupi i numërimit të votave përbëhet nga 4 anëtarë, ku një nga anëtarët është numëruar i parë, një sekretar dhe 2 anëtarë.
3. Grupi i numërimit të votave funksionon minimalisht me 2 anëtarë.

Neni 3
Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave

1. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave instalohet në çdo VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me sistemin e teknologjisë mbështetëse përkatëse.
2. KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV.
3. Grupi i numërimit të votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamer, sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzim.
4. Në rast se sistemi i teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, ka difekt në një apo më shumë tavolina numërimi, nuk pengohet procesi i numërimit të votave.
5. KZAZ-ja njofton ndihmësit teknikë dhe KQZ-në për difektin e ndodhur. GNV-të vazhdojnë procesin e numërimit të votave. Në këtë rast KZAZ-ja lejon vëzhguesit e koalicioneve që nuk kanë anëtar në GNV të afrohen pranë tavolinës së numërimit të votave. Kjo procedurë dhe ora e saktë e ndërprerjes dhe rifillimit të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit, shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve.
6. Në rast se grupi i numërimit të votave funksionon me 2 anëtarë, sipas përcaktimit të nenit 95 pika 3 të Kodit Zgjedhor, detyrimisht ky proces duhet të jetë i regjistruar nga kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluar në ambientet e VNV-së. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon për çfarëdo arsye dhe numërimi i kutisë nuk ka përfunduar, atëherë numëruesit përfundojnë numërimin e kësaj QV dhe procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse (kamerave) ose plotësimin e grupit të numërimit të votave. Kjo procedurë dhe ora e saktë e ndërprerjes dhe rifillimit të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit, apo e plotësimit të grupit të numërimit të votave shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.

PJESA II
MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 4

Ngritja e grupeve të marrjes në dorëzim

1. Për marrjen në dorëzim të bazës së materialeve zgjedhore nga KQV-ja në KZAZ, ngrihen një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim.
2. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së, me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.
3. Nëse është e nevojshme, KZAZ cakton 2 persona në ndihmë të çdo grupi të marrjes në dorëzim, nga lista e anëtarëve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Në caktimin e tyre duhet pasur parasysh përkatësia politike dhe baraspeshimi shumicë-opozitë. Propozimet për caktimin e këtyre dy personave bëhen nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Neni 5

Funksionimi dhe detyrat e grupit të marrjes në dorëzim

1. Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore ngrihet dhe funksionon vetëm për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-të në VNV.
2. Materialet zgjedhore merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në VNV. Në rast se gjatë procesit të marrjes në dorëzim krijohet radhë, KZAZ-ja cakton një grup ndihmës të përbërë nga 2 persona, të cilët caktohen sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij udhëzimi, për të orientuar KQV-të.
3. Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë së votimit, kutisë së materialeve zgjedhore apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat vijnë në VNV nga KQV-të.

Neni 6

Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor

Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore, grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedurë:

- a) Merr nga KZAZ-ja, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV, dhe që përmban: Procesverbalin Model PV-KZAZ-06 të dhënies së kodeve të sigurisë dhe modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së.
- b) Verifikon përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore, me numrat e kodeve të sigurisë së vulave të shënuara në Procesverbalin Model PV-KZAZ-06.
- c) Verifikon nëse mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie.
- d) Verifikon nëse vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj.
- e) Verifikon nëse kutia ka në trupin apo në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër zgjedhor.
- f) Verifikon nëse kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin nr.16, datë 26.02.2009 të KQZ-së.
- g) Plotëson procesverbalin e marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore Model PV-KZAZ-09, i cili nënshkruhet nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së, si dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, i caktuar për shoqërimin e materialeve zgjedhore nga KQV-ja në VNV.

Neni 7

Kutitë e votimit të deklaruaruara “KUTI E PARREGULLT”

1. Në rast se gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutisë së fletëve të votimit apo asaj të materialeve zgjedhore, konstatohet një apo më shumë parregullsi të parashikuara në germet b, c, d, e dhe f të nenit 6 të këtij udhëzimi, grupi i marrjes në dorëzim, njofton menjëherë KZAZ-në për parregullsinë dhe i kërkon kësaj, që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”.

2. KZAZ-ja, pasi verifikon parregullsitë e parashtruara nga grupi i marrjes në dorëzim, merr vendim duke e vlerësuar kutinë si të parregullt dhe i vendos etiketën “KUTI E PARREGULLT”.

3. Të gjitha mospërputhjet apo parregullsitë e konstatuara gjatë këtij procesi, shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit.

4. Kutia e fletëve të votimit, e përcaktuar si “KUTI E PARREGULLT”, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ-ja dhe nuk i kalon GNV-ve për vlerësim.

5. Në rast se kutia me fletët e votimit konsiderohet “KUTI E PARREGULLT”, atëherë edhe kutia e materialeve zgjedhore të kësaj QV-je nuk hapet pasi, e vetme, nuk shërben për nxjerrjen e një rezultati për QV-në përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në nenet 116 deri në 119 të Kodit Zgjedhor.

6. Në rastet kur kutia me fletët e votimit është marrë në dorëzim e rregullt dhe kutia e materialeve zgjedhore përcaktohet “KUTI E PARREGULLT”, ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit së bashku me kutinë e votimit me fletët e votimit. Në çdo rast, parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si “KUTI E PARREGULLT”, shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit.

7. Kutitë e votimit të vlerësuara si “KUTI E PARREGULLT”, vendosen në një vend të veçantë së bashku me kutinë e materialeve zgjedhore të kësaj QV-je, që të dallohen nga kutitë e tjera. Këto kuti, dërgohen në KQZ, së bashku me materialet e tjera për nevojë të hetimit administrativ.

Neni 8

Sistemimi i kutive të votimit në VNV

1. KZAZ-ja cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë e votimit dhe të materialeve zgjedhore para numërimit dhe kutitë e votimit dhe të materialeve zgjedhore pas numërimit, sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur udhëzimit nr. 12 të KQZ-së, si dhe një hapësirë për kutitë e votimit të vlerësuara “KUTI E PARREGULLT”.

2. Sapo kutitë e votimit janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e caktuar. Ky proces mbikëqyret nga KZAZ-ja.

3. Kutitë vendosen në pozicion vertikal, njëra mbi tjetrën në mënyrë që sipër kutisë me fletët e votimit të jetë kutia e materialeve zgjedhore.

4. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, renditen sipas numrit të qendrës së votimit. Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës së tyre. E para në radhë duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh. QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së mëmë.

PJESA III

VEPRIMET PARAPRAKE TË KZAZ

Neni 9

Veprimet paraprake

Pasi janë marrë në dorëzim të gjitha materialet zgjedhore dhe pasi është siguruar që të gjithë anëtarët e GNV-ve kanë marrë trajnimin e nevojshëm, KZAZ-ja merr masat paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave si më poshtë:

a) Sigurohet që vendi i numërimit të votave është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave.

b) Sigurohet që anëtarët e grupeve të numërimit janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat përkatëse të numërimit.

c) Grupet e numërimit janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave.

d) Verifikon që të pranishëm në VNV, janë vetëm personat e parashikuar në nenin 10 të këtij udhëzimi.

e) Merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

Neni 10

Personat e pranishëm në VNV

1. Gjatë procesit të numërimit të votave në VNV janë të pranishëm, vetëm:

- a) Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së;
- b) Anëtarët e grupeve të numërimit të votave të cilët futen në punë;
- c) Përfaqësuesit e akredituar të medias;
- d) Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
- e) Vëzhguesit e tjerë të akredituar;
- f) Kandidatët për deputet;
- g) Operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

2. Të gjithë personat e pranishëm në VNV, duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre.

3. Personat e përmendur në gjerat d, e, dhe g të pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me autorizim të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

Neni 11

Fillimi i procesit të numërimit të votave

KZAZ-ja merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave, pasi ka marrë në dorëzim edhe bazën materiale të QV-së së fundit nën juridiksionin e saj. Në vendim shënohet dhe ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave.

Kjo procedurë shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve.

PJESA IV

PROCEDURAT QË NDIQEN ME KUTINË E MATERIALEVE ZGJEDHORE DHE KUTINË E VOTIMIT

Neni 12

Rendi i veprimeve të GNV-së

1. Sekretari i grupit të parë të numërimit ndjek procedurën si më poshtë:

a) Nën kujdesin e një anëtari të ngarkuar nga KZAZ-ja, merr me radhë sipas numrit rendor rritës, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore të një qendre votimi dhe i vendos ato pranë tavolinës së grupit të numërimit.

b) Merr nga sekretari i KZAZ-së dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV dhe ku ndodhet procesverbali Model PV-KZAZ-06, i dhënies së kodeve të sigurisë dhe modeli krahasues i vulës së kryetarit të KQV-së.

2. Numëruesi i parë merr kutinë e materialeve zgjedhore, e cila është edhe kutia që vlerësohet e para dhe e vendos atë mbi tavolinën e numërimit. Pasi këput kodet e sigurisë, e hap atë dhe kryen këto veprime:

a) Nxjerr nga kutia procesverbalin e mbylljes së votimit MODEL PV-KQV-09, si dhe vulën e kryetarit të KQV-së.

b) Verifikon nëse në kutinë e materialeve të votimit ndodhen:

- i) zarfi “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA” së bashku me kundërilet;
- ii) zarfi “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;
- iii) lista e zgjedhësve, përfshirë dhe regjistrin e posaçëm;

- iv) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;
 - v) vula e KQV-së;
 - vi) vula e kryetarit të KQV-së;
 - vii) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
 - viii) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka; dhe
 - ix) Libri i protokollit të mbledhjeve të KQV-së.
- c) Krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ua bën të ditur anëtarëve të grupit.
3. Pasi ka kryer procedurat e mësipërme, numëruesi i parë numëron:
- a) fletët e votimit të papërdorura;
 - b) fletët e votimit të dëmtuara;
 - c) zgjedhësit që kanë votuar, sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve, përfshirë edhe ata, emri i të cilëve është shënuar në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve.
4. Për çdo rast, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, në përfundim të numërimit, numëruesi i parë ua bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Sekretari i grupit të numërimit në çdo rast bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në procesverbalin për mbylljen e votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të grupit të numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e materialit zgjedhor të kontestuar.
5. Numëruesi i parë, llogarit dhe deklaron numrin e fletëve të votimit të përdorura, i cili del nga diferenca e totalit të fletëve të votimit të marra në dorëzim me numrin e fletëve të votimit të papërdorura. Sekretari i GN-së bën verifikimin e shifrës së deklaruar me atë që është shënuar në procesverbalin për mbylljen e votimit Model PV-KQV-08.
6. Në rast se nga verifikimet e kryera nga grupi i numërimit sipas këtij neni, konstatohen pasaktësi apo parregullsi, atëherë grupi i numërimit apo cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore njofton menjëherë KZAZ-në, veprim i cili kryhet me ngritjen e dorës. Ngritja e dorës pezullon procesin derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen, ta verifikojë atë dhe të marrë vendimin për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave që duhen ndjekur në vazhdim me kutinë e materialeve zgjedhore.
7. Pas kryerjes së procedurave të sipërcituara, sekretari i grupit të numërimit shënon numrat e kodeve në procesverbalin e grupit të numërimit për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, Model PV-GNV-10, e fut atë në këtë kuti dhe më pas numëruesi i parë i grupit të numërimit mbyll kutinë e materialeve zgjedhore me vulat me kode sigurie, duke lënë jashtë kutisë vetëm procesverbalin për mbylljen e votimit Model PV-KQV-08. Kutia e materialeve zgjedhore vendoset pranë tavolinës së numërimit.

Neni 13

Numërimi i fletëve të votimit

1. Në vijim, numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë e votimit me fletët e votimit dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë.
2. Numëruesi i parë dhe anëtarët e grupit të numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me procesverbalin e vulosjes Model PV-KQV-07. I shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me faqen e pasme të fletës nga ana e sipërme.
3. Fletët e votimit të stivuara sa më sipër numërohen nga numëruesi i parë, i cili, në përfundim të numërimit, ua bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Shifra e deklaruar verifikohet me shifrën që del nga diferenca e numrit të fletëve të votimit të përdorura me numrin e fletëve të votimit të dëmtuara. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të grupit të numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe njëherë numërimin e fletëve të votimit.
4. Në rast se nga verifikimet e kryera, sipas këtij neni, konstatohen pasaktësi ose parregullsi, atëherë GNV-ja, ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi.

5. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri sa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësi ose parregullsi, e pasqyron atë në procesverbalin e konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në procesverbalin e konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave, nga GNV-ja.

Neni 14

Vlerësimi i fletës së votimit

1. GNV-ja bën ndarjen e hapësirës së tavolinës së numërimit, duke përcaktuar vendet e veçanta për fletët e votimit, të vlefshme, të pavlefshme dhe të kontestuara.

2. Numëruesi i parë vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së.

3. Gjatë shfaqjes të fletës së votimit nga faqja e pasme, numëruesi i parë verifikon nëse:

a) Fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja.

b) Në fletën e votimit është vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së.

c) Në fletën e votimit, janë bërë shënime, shenja apo nënshkrime që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit.

4. Në këtë rast, numëruesi i parë shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.

5. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e caktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

6. Kjo fletë votimi do të vlerësohet përsëri nga grupi i numërimit në momentin e rivlerësimit të votave.

7. Në rast se fleta e votimit, e vlerësuar si e pavlefshme, nuk ka pasur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së.

Neni 15

Vlerësimi i votave

1. GNV-ja bën ndarjen e hapësirës së tavolinës së numërimit, duke përcaktuar vendet e veçanta për fletët e votimit të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor, duke pasur parimin, fletët e votimit të partive të të njëjtit koalicion zgjedhor, grupohen veçmas dhe pranë njëra-tjetrës, duke bërë identifikimin për secilën prej partive anëtare të koalicionit.

2. Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas numërimit të fletëve të votimit dhe vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

3. Fletët e votimit të vlerësuara nga grupi i numërimit ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme dhe në fletë votimi të kontestuara.

4. Numëruesi i parë i grupit të numërimit, në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e pavlefshmërisë së votës, çmon dhe pastaj u propozon për vlerësim anëtarëve të tjerë, të asaj partie politike apo kandidati që i është hedhur vota.

5. Numëruesi i parë është i detyruar t'ua tregojë fletët e votimit anëtarëve të grupit të numërimit. Numëruesi i parë vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që të shikohet qartësisht në monitor shenja, e cila tregon vullnetin e zgjedhësit.

6. Numëruesi i parë i grupit të numërimit, bën vlerësimin e votës me zë të lartë.

7. Në rast se anëtarët e grupit të numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për partinë politike për të cilën është votuar. Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedurë.

8. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye fletët e votimit nuk shfaqen më shumë se një herë në kamera.

Neni 16

Kontestimi dhe rivlerësimi i votës

1. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose vëzhguesve të tavolinës përkatëse, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit.
2. Kontestimi i votës bëhet duke ngritur dorën e duke thënë “NUK JAM DAKORD”.
3. Në përfundim të vlerësimit të fletëve të votimit që i takojnë çdo subjekti zgjedhor, grupi i numërimit rivlerëson fletët e votimit të kontestuara.
4. Rivlerësimi bëhet nga grupi i numërimit dhe nuk i nënshtrohet procesit të shfaqjes së fletës së votimit të kontestuar në kamerë.
5. Gjatë procesit të rivlerësimit, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë të kontestojnë votat dhe as të kërkojnë rishfaqjen e tyre në monitor. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit.
6. Në rast se edhe pas rivlerësimit nga GNV-ja, ka fletë votimi të kontestuara nga të paktën 1 anëtar i GNV-së, atëherë GNV-ja thërret KZAZ-në për vlerësimin e votave të kontestuara të asaj kutie.
7. Për secilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i grupit të numërimit shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit. Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse, shënohet në procesverbalin Model PV-GNV-10-1.
8. KZAZ-ja bën në çast vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje me të, duke e vlerësuar në votë të vlefshme apo në votë të pavlefshme. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave Model 57-09.
9. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA”.

Neni 17

Numërimi i votave të çdo subjekti zgjedhor

1. Pas vlerësimit të votave, numëruesi i parë numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit. Pas çdo numërimi, shifrën ua bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Në rast se kërkohet nga ndonjë anëtar i Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë subjekt.
2. Në rast se, edhe pas këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë ose anëtari kundërshtues, njofton KZAZ-në nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ-ja. KZAZ-ja numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron grupin e numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

Neni 18

Nxjerrja e rezultatit nga GNV-ja

1. Pas përfundimit të procedurës të parashikuar më sipër, anëtarët e grupit të numërimit, plotësojnë tabelën e rezultateve Model 57-09, për atë qendër votimi.
2. Në rast se kanë kundërshtime, anëtarët e GNV-së, bëjnë shënimet përkatëse në tabelën e rezultateve. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave janë të detyruar të nënshkruajnë tabelën e rezultateve.
3. Tabela origjinale e rezultateve, e plotësuar nga anëtarët e grupit të numërimit, duke përfshirë edhe kundërshtimet, nëse ka, shfaqet përpara kamerës për jo më pak se 5 sekonda. Anëtarët e GNV-ve marrin një kopje të tabelave të rezultateve Model 57-09.
4. Tabela origjinale e rezultateve i dorëzohet menjëherë dorazi KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së ia përcjell tabelën e rezultateve, operatorit teknik për transmetimin e të dhënave në rrugë elektronike nga VNV-ja në KQZ.

5. Pas transmetimit të të dhënave në KQZ, kopje të tabelave të rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

Neni 19

Mbyllja e kutisë së votimit

Pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve nga GNV-ja, fletët e votimit futen në zarfe, të ndara sipas subjekteve zgjedhore, votat e pavlefshme futen në zarfin “VOTA TË PAVLEFSHME”, fletët e votimit të kontestuara, janë grupuar në një zarf më vete me shënimin “FLETË VOTIMI TË KONTESTUARA” sipas pikës 9 të nenit 16 të këtij udhëzimi. Më pas të gjitha këto zarfe, përfshi zarfin me procesverbalin Model PV-KQV-07 dhe procesverbalin e mbylljes së votimit Model PV-KQV-08, futen në kutinë e votimit dhe mbyllet me vula me kode të reja, të cilat shënohen në tabelën e rezultateve Model 57-09.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM

Nr.19, datë 9.6.2009

PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË TRETË DHE TË KATËRT TË GNV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 28 QERSHOR 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 95, pika 2 dhe nenit 96 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat e organizimit të shortit, për caktimin e partive, të cilave u lind e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për çdo ZAZ.

Neni 2

1. KQZ hedh short sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim për çdo ZAZ dhe merr vendim për caktimin e partive, të cilave u lind e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve në ZAZ-në përkatëse.

2. Përcaktimi i dalë nga shorti ka efekt për të gjitha grupet e numërimit brenda ZAZ-së përkatëse.

3. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit shpallet në hyrje të KQZ-së.

4. Hedhja e shortit organizohet në seancë publike.

Neni 3

Partitë të cilat marrin pjesë në short

1. Partitë pjesëmarrëse në short, janë të gjitha partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë kanë fituar jo më pak se dy mandate dhe janë regjistruar në KQZ, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28 qershor 2009.

2. Nga ky short përjashtohen partitë, të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve, respektivisht partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare.

Neni 4

Anëtari i tretë dhe i katërt

1. Shorti për anëtarin e tretë të GNV-ve, hidhet ndërmjet partive të shumicës parlamentare, të cilave u ka lindur e drejta të marrin pjesë në short.

2. Shorti për anëtarin e katërt të GNV-ve, hidhet ndërmjet partive të opozitës parlamentare, të cilave u ka lindur e drejta të marrin pjesë në short.

Neni 5

Veprimet paraprake

1. Në datën dhe në orën e caktuar për organizimin e shortit, sekretari i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të partive politike, të cilave u ka lindur e drejta të marrin pjesë në short, sipas vendimit të KQZ-së dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

2. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike, nuk pezullon procedurat e shortit, KQZ, me vendim të ndërmjetëm, cakton një punonjës të administratës të tërheqë shortin për partinë politike, përfaqësuesi i së cilës nuk është prezent.

Neni 6

Procedura e shortit

1. Dy enë transparente, ku në njërën është vënë etiketa “Partia politike e cila tërheq shortin për anëtarin e tretë” dhe në tjetrën “Partia Politike e cila tërheq shortin për anëtarin e katërt”, vendosen në një tavolinë, e cila shikohet qartë nga të gjithë anëtarët e KQZ-së, dhe përfaqësuesit e partive politike.

2. Dy enë të tjera transparente, ku në njerën është vënë etiketa “Anëtari i tretë i GNV-ve dhe në tjetrën “Anëtari i katërt i GNV-ve”, vendosen në një tavolinë, e cila shikohet qartë nga të gjithë anëtarët e KQZ-së dhe përfaqësuesit e partive politike.

3. Emri i çdo partie politike, së cilës i lind e drejta për të marrë pjesë në short, për anëtarin e tretë të GNV-ve shënohet në shirita letre dhe mbyllet në gogla të njëjta nga ngjyra dhe forma e jashtme dhe hidhen në enët transparente ku është shënuar “Partia politike, e cila tërheq shortin për anëtarin e tretë” dhe “Anëtari i tretë i GNV-ve”.

4. Emri i çdo partie politike, së cilës i lind e drejta për të marrë pjesë në short, për anëtarin e katërt të GNV-ve shënohet në shirita letre dhe mbyllet në gogla të njëjta nga ngjyra dhe forma e jashtme dhe hidhet në enët transparente ku është shënuar “Partia politike e cila tërheq shortin për anëtarin e katërt” dhe “Anëtari i katërt i GNV-ve”.

5. Një përfaqësues i KQZ-së tërheq njërën nga goglat e hedhura në enët e para ku është shënuar “Partia politike, e cila tërheq shortin për anëtarin e tretë” dhe “Partia politike, e cila tërheq shortin për anëtarin e katërt”.

6. Pas përcaktimit të bërë në këtë parashort, shiriti i letrës futet sërish në gogël dhe hidhet në enën nga ku u tërhoq.

7. Përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda goglës së tërhequr nga ena ku është shënuar “Partia politike, e cila tërheq shortin për anëtarin e tretë”, ka të drejtën të tërheqë shortin për anëtarin e tretë të GNV-ve në enën e dytë ku është shënuar “Anëtari i tretë i GNV-ve”.

8. Partia e cila fiton nga ky short, ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të grupeve të numërimit të ZAZ-së përkatëse.

9. Përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda goglës së tërhequr nga ena ku është shënuar “Partia politike, e cila tërheq shortin për anëtarin e katërt” ka të drejtë ta tërheqë shortin për anëtarin e katërt të GNV-ve në enën e dytë ku është shënuar “Anëtari i katërt i GNV-ve”.

10. Partia e cila fiton nga ky short, ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të ZAZ-së përkatëse.

Neni 7

1. Punonjësi i administratës dhe përfaqësuesi i subjektit zgjedhor, pasi e hap gogllën, ia dorëzon shiritin e letrës që gjendet brenda saj, sekretarit të KQZ-së, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.

2. Në rast se kërkohet nga anëtarët e KQZ-së apo nga çdo përfaqësues i partive politike, gogla e përdorur një herë mund të zëvendësohet me një gogël tjetër të papërdorur.

Neni 8

1. Procedura e hedhjes së shortit, përsëritet në të njëjtën mënyrë për të gjitha ZAZ-të.

2. Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KQZ merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit për çdo ZAZ.

Neni 90

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr.38, datë 18.5.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË KODIN E FUNKSIONIMIT TË RRJETIT (KODI I TRANSMETIMIT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 26 pika 2 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.5.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), të cilat do të mundësojnë përdorimin e njësive gjeneruese të parregullueshme në disa HEC-eve të reja,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), i miratuar me vendimin nr.123, datë 24.10.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. (Ndryshimet bashkëlidhur këtij vendimi)

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.39, datë 18.5.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLAT
E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 26 pika 2 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s dhe vendimit nr.68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, pika XIX.1.1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.5.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga OST sh.a. për ndërhyrjen në dispozitat e rregullave të tregut, që lidhen me rregullat për alokimin e kapacitetit të interkonjeksionit,

VENDOSI:

1.Fillimin e procedurave për disa ndryshime dhe shtesa në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin nr.68, datë 23.6.2008.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.40, datë 18.5.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË TREGUN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës III.1.1 të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.5.2009, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga OST sh.a. për miratimin e “Rregullores për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.853, datë 15.5.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT
TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TNSH”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe kërkesës së subjektit të datës 5.5.2009,

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin nr.529, datë 13.11.2006 të KKRT-së “Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor privat TNSH”.
2. Të rinovojë licencën me nr.037/TVL për subjektin televiziv privat vendor “TNSH”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.857, datë 15.5.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV CABLE TEL”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe kërkesës së subjektit të datës 14.5.2009, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin nr.839, datë 24.4.2009 të KKRT-së, për mosdhënie licence shoqërisë “Cable Tel” sh.p.k.
2. T’i japë licencë shoqërisë “Cable Tel” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qytetin e Tiranës.
3. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË
Nr.1680/1, datë 19.5.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano-Durrës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 424 976 (një milion e katërqind e njëzet e katërmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTESE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I RRUGES
" Porto Romano-Durres "

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadast	Nr. Pasurise	Siperf. pergjith	LLOJI I PASURISE					Shuma: VL.(leke)	Shenime	
							TRUALL		Are		VL.(lek)			
							M ²	Çmimi	VL.(Leke)	m2	cmimi			VL.(lek)
1	Kastriot		Dyrmish	8517	104/14	13338				1915	112	214480	Konf.ZVRPP	
2	Olsi		Ceci	8517	104/15	4104				1370	112	153440	Konf.ZVRPP	
3	Zyhdi		Lala	8517	104/10	12312				2231	112	249872	Konf.ZVRPP	
4	Asllan		Marku	8517	104/9	9234				1716	112	192192	Konf.ZVRPP	
5	Zibe		Tola	8517	104/8	4104				836	112	93632	Konf.ZVRPP	
6	Aferdita		Hoxha	8517	104/7	4104				807	112	90384	Konf.ZVRPP	
7	Ali		Badolli	8517	104/6	4104				744	112	83328	Konf.ZVRPP	
8	Shqipe		Bodolli	8517	104/5	4104				760	112	85120	Konf.ZVRPP	
9	Florina		Hoxha	8517	104/4	4104				803	112	89936	Konf.ZVRPP	
10	Hafizet		Abazi	8517	104/3	4104				811	112	90832	Konf.ZVRPP	
11	Ylvi		Isaku	8517	104/2	4104				730	112	81760	Konf.ZVRPP	
Shuma:										12723		1424976		

KËRKESË

Nr.1732/1, datë 21.5.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i ndërtimit të segmentit rrugor “Ruga Hyrëse-Fier”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit truall.

Pronarët, për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 018 800 (katër milionë e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË DUHET TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR HYRJA FIER

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.kad.	Nr.pas.		Sip (m2)	Çmimi (l/m ²)	Vlera (lekë)	Shënime
1	Vllasi	Divia	8532	3/276	truall	8	12000	96000	Konf.nga ZRPP
2	Vllasi	Divia	8532	3/277	Truall	3.7	12000	44400	Konf.nga ZRPP
3	Nasi	Divia	8532	3/280	Truall	4.6	12000	55200	Konf.nga ZRPP
4	Themi	Divia	8532	3/281	Truall	2	12000	24000	Konf.nga ZRPP
5	Marie	Doko	8532	3/273	Truall	1	12000	12000	Konf.nga ZRPP
6	Edmond	Lumani	8532	3/216	Truall	36	12000	432000	Konf.nga ZRPP
7	Edmond	Lumani	8532	3/214	Truall	13	12000	156000	Konf.nga ZRPP
8	Shpëtim	Rizai	8532	2/120	Truall	25.6	12000	307200	Konf.nga ZRPP
9	Elida	Kepucka	8532	2/310	Truall	22	12000	264000	Konf.nga ZRPP
10	Qazim	Sopjani	8532	2/87	Truall	79	12000	948000	Konf.nga ZRPP
11	Dano	Xhemaj	8532	2/164	truall	140	12000	1680000	Konf.nga ZRPP
	Shuma					334.9			

KËRKESË

Nr.1381/2, datë 22.5.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët është bërë shënimi “Rikonfirmim”, për arsye se nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë janë konfirmuar të dhëna jo të qarta, gjithashtu disa pronarë nuk janë konfirmuar, për pasuritë për të cilat pretendojnë.

Për sa më sipër me mbarimin e afatit dy javor të ankesave, për të gjithë pronarët do të rikërkohet konfirmimi i titullit të pronësisë pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë. Në varësi të të dhënave që do të rezultojnë nga konfirmimi zyrtar i kësaj zyre, do të hartohen listat përfundimtare që do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave, si rrjedhojë mund të ketë ndryshime në sipërfaqet e publikuara dhe në vlerën përkatëse të shpronësimit.

Të gjithë pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 93 833 627.1 (nëntëdhjetë e tre milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë një) lekë.

LISTA E PRONAREVE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME PRONE PRIVATE QE PREKEN SI REZULTAT I RRUGES "TRANSBALLKANIKE"

Lloji I Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Pas.	Sip. Totale Pron	ZK	TRUALL			Objekte			Vlera totale ne leke	Shenime
							Sip. (m2)	Cnimi L/m2	Vlefte ne leke	Sip. (m2)	Cnimi L/m2	Vlefte ne leke		
1	Bashkepronaret Skendaj			18/3	397.92 T 176.87ND 116 T, 82.2	8603				18.4	31137	572920.8	572920.8	Rikonfirmim
2	Nuri			20/93	ND	8603				20	31137	622740	622740	Rikonfirmim
3	Stavri		Dino	18/11	450 T	8603	88	24860	2187680				2187680	Rikonfirmim
4	Resul Rakip Sokol	Hamit Hamit Hamit	Agaci Agaci Agaci	18/10	887 T	8603	101	29842	3014042				3014042	Rikonfirmim
5	Tokli		Qarri	18/12	441.77 T 111.88 ND 837 T 210	8603	68	29842	2029256				2029256	Rikonfirmim
6	Bashkepronaret		Konstandini	33/128	ND	8604	381	22748	8666988	210	67100	14091000	22757988	Rikonfirmim
7	Bashkepronaret		Kona + Janina	35/68	1000 T 105ND	8604	389	22748	8848972				8848972	Rikonfirmim
8	Sanje		Arap	4/122		8604				57.4	67100	3851540	3851540	Rikonfirmim
9	Albert	Hamdi	Veizaj	5/39	45 ND	8604				45	67100	3019500	3019500	Rikonfirmim
10	Ramiz		Ismaili	4/176	319 T 319 T	8604	20	14392	287840	73	67100	4898300	5186140	Rikonfirmim
11	Azbi		Ismaili	4/242: 4/3	177ND	8604	15	14392	215880	104	67100	6978400	7194280	Rikonfirmim
12	Flora Hito		Cekodhima Hita	5/46	54 T 54 ND	8604	3	14392	43176	23	67100	1543300	1586476	Rikonfirmim

KËRKESË

Shtetasi Idajet Sinjari, i datëlindjes 15.2.1955, lindur në fshatin Skrevan, Berat dhe me banim në fshatin Vokopolë, bashkia Berat, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Zamira Idajet Sinjari, e datëlindjes 23.3.1986, lindur dhe banuese në fshatin Vokopolë, bashkia Ura Vajgurore Berat, duke shpallur si datë vdekjeje 8 gusht 2002.

KËRKUESI
Idajet Sinjari

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 18.6.2009
Doli nga shtypi më 18.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë